

ePeriodik

PUBLIKIM MUJOR NUMRI 120 | Dhjetor 2018

2019



Gëzuar Festat e Fundvitit!

Mbrojmë Konsumatorët - Promovojmë Tregjet - Zbatojmë Ligjin

Për informacion të mëtejshëm
ju lutemi na kontaktoni:

Rruga "Dora Distra", Nr.10, P.O. Box 8363, Tiranë
Tel: +355 42 251 355/6 | Fax: +355 42 250686
amf@amf.gov.al | www.amf.gov.al

PËRMBAJTJA

Takim përmbyllës me përfaqësues të medias dhe tregjeve nën mbikëqyrje

Vështrim mbi tregjet

- Zhvillimet e Tregut të Sigurimeve në Shqipëri për periudhën janar-nëntor 2018

Zhvillime të tjera

- AMF këshillon qytetarët për policat kufitare
- INVESTITORE KUJDES: Ndaj aktivitetit të shoqërisë me emrin Fortrade
- AMF me studentët e “Tirana Business University” për rritjen e edukimit financiar
- Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i AMF-së takohet me përfaqësues të lartë të MONEYVAL
- AMF bashkëpunon me projektin e Swisscontact “Aftësi për Punë” për edukimin financiar në shkollat e mesme profesionale
- Takim i nivelit të lartë ndaj sfidave në tregjet e sigurimeve të rajonit të Evropës Juglindore
- Konferencë vjetore për mbikëqyrjen financiare
- Takimi i tretë i 6 vendeve të Ballkanit Perëndimor – Grup Pune për Tregjet e Kapitalit

Edukimi i Konsumatorit

- Tejkalmimi i limiteve në sigurueshmëri (*pjesa e parë*)

Fjalor Termash

Lajme Ndërkombëtare

- Bullgari
- Maqedoni
- Poloni
- Qipro
- Rumani

Takim përmblyllës me përfaqësues të medias dhe tregjeve nën mbikëqyrje



Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i AMF-së, Z. Ervin Koçi dhe përfaqësues të medias

Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, Z. Ervin Koçi, zhvilloi një takim me gazetarë të medias së shkruar dhe elektronike që pasqyrojnë zhvillimet ekonomike dhe financiare në vend.

Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, Z. Ervin Koçi, zhvilloi një takim me gazetarë të medias së shkruar dhe elektronike që pasqyrojnë zhvillimet ekonomike dhe financiare në vend. Takimi ishte në përmblyllje të komunikimeve të vazhdueshme të AMF-së me median gjatë vitit 2018.

Duke i falenderuar gazetarët për bashkëpunimin në pasqyrimin e ecurisë së tregjeve nën mbikëqyrje, Drejtori Ervin Koçi theksoi edhe projektet zhvilluese të Autoritetit përgjatë vitit 2019 duke veçuar kujdesin për të mbrojtur investitorin dhe konsumatorin.

Drejtues të AMF-së zhvilluan takim edhe me përfaqësues të tregjeve nën mbikëqyrje për projektet zhvillimore gjatë vitit 2019.

VËSHTRIM MBI TREGJET

Zhvillimet e Tregut të Sigurimeve në Shqipëri për periudhën janar-nëntor 2018


Të ardhurat nga primet e shkruara bruto për periudhën janar-nëntor 2018 kapën vlerën mbi 15,149 milionë lekë, ose 6.02% më shumë se në periudhën janar-nëntor 2017. Gjatë periudhës janar-nëntor 2018, numri i kontratave të sigurimit të lidhura arriti në 1,174,224 me një rritje prej 5.62% krahasuar me periudhën janar-nëntor 2017.

Tregu vazhdoi të mbetet sërish i orientuar tek sigurimet e Jo-Jetës, të cilat sollën 93.09% të vëllimit të përgjithshëm të primeve, duke i lënë përkatësisht sigurimet e Jetës me 6.62% dhe veprimtarinë e risigurimit me 0.29%. Parë nga këndvështrimi i ndarjes së tregut sipas llojit të sigurimit, i detyrueshëm dhe vullnetar, primet e shkruara bruto të sigurimit vullnetar zënë 36.9% dhe primet e shkruara bruto të sigurimit të detyrueshëm zënë 63.1% të totalit të tregut.

Gjatë periudhës janar-nëntor 2018, dëmet e paguara bruto në tregun e sigurimeve, arritën në rreth 6,175 milionë lekë, ose 24.03% më shumë se në periudhën janar-nëntor 2017.

Gjatë periudhës janar-nëntor 2018, dëmet e paguara bruto në tregun e sigurimeve, arritën në rreth 6,175 milionë lekë, ose 24.03% më shumë se në periudhën janar-nëntor 2017.

Struktura e tregut të sigurimeve, janar-nëntor 2018



AMF këshillon qytetarët për policat kufitare

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare këshillon qytetarët që udhëtojnë drejt Shqipërisë me automjetet e tyre me targa të huaja të presin policat kufitare vetëm në pika të autorizuar dhe nga agjentë të licencuar. Në çdo pikë të kalimit të kufirit në Shqipëri gjenden agjentë të shoqërive të sigurimit pranë të cilave mund të pajiseni me policat kufitare. Këta agjentë janë miratuar nga AMF dhe punojnë për shoqëritë e sigurimit për shitjen e policave kufitare. Ata mund ta kryejnë këtë veprimtari vetëm brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.

Çdo policë e sigurimit kufitar që mund t'iu ofrohet pa hyrë në territorin e Republikës së Shqipërisë, apo që është e plotësuar me shkrim dore dhe jo me mjete elektronike, është në kundërshtim me rregullat e legjislacionit shqiptar, dhe si e tillë është e pavlefshme.

Që një policë kufitare të jetë e vlefshme, ajo duhet të figurojë në regjistrin online në faqen zyrtare të AMF-së. Elementët e sigurisë që duhet të ketë Polica Kufitare janë:

- Numri i serisë së policës është unik dhe duhet të fillojë me dy shifrat e fundit të vitit aktual. (Shembull: Viti 2018 = 18xxxxxx).
- Polica e sigurimit kufitar është e shkruar në format elektronik dhe në asnjë rast me shkrim dore.
- Polica ka një numër unik të rastësishëm identifikues të policës së sigurimit në regjistrin elektronik online të shitjeve të sigurimit të detyrueshëm motorik me elementë sigurie të gjeneruar nga AMF.

Raportimi dhe identifikimi i policave kufitare të shitura nga kompanitë e sigurimit bëhet në kohë reale nëpërmjet regjistrit elektronik online të shitjeve. Këtë mund ta bëjnë nëpërmjet faqes zyrtare të Autoritetit, www.amf.gov.al, në rubrikën “Verifikoni Policën tuaj”, duke ndjekur gjithë hapat e nevojshëm, ose duke dërguar me SMS numrin e targës tuaj në numrin e celularit +355694060671.

Për çdo problem që mund t'ju lindë në lidhje me policën, lutemi të kontaktoni në adresën konsumatori@amf.gov.al ose të na shkruani në inbox-in e faqes tonë në Facebook.

AMF i bën thirrje qytetarëve të tregohen të kujdesshëm dhe të verifikojnë policën e tyre kufitare.

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare këshillon qytetarët që udhëtojnë drejt Shqipërisë me automjetet e tyre me targa të huaja të presin policat kufitare vetëm në pika të autorizuar dhe nga agjentë të licencuar.

INVESTITORË KUJDES: Ndaj aktivitetit të shoqërisë me emrin Fortrade

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF) paralajmëron investitorët për rrezikun ndaj shërbimeve të shoqërisë që operon me emrin Fortrade nëpërmjet adresës së internetit <https://www.fortrade.com>.

Mbështetur në Ligjin nr. 9879, datë 21.2.2008 “Për Titujt” dhe Vendimin nr. 55 datë 30.03.2011 “Për njohjen e veprimtarisë së agjentit të brokerit të licencuar të letrave me vlerë”, një shoqëri brokerimi e huaj lejohet të ofrojë shërbimet e saj në vendin tonë, përmes një “agjenti” të themeluar si shoqëri brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, pas miratimit nga AMF.

Shoqëria Fortrade, e cila ofron për tregun shqiptar instrumente financiare nuk është e licencuar nga Autoriteti për të ofruar shërbime investimi në Republikën e Shqipërisë.

Për këtë arsye, Autoriteti i bën thirrje investitorëve të bëjnë shumë kujdes përpara se të marrin një vendim në lidhje me pranimin e një oferte të kryer nëpërmjet telefonatave ose mjeteve të tjera të komunikimit për t'i nxitur ata të regjistrohen ose hapin llogari në platformën online të shoqërisë Fortrade, nëpërmjet faqes së saj të internetit <https://www.fortrade.com>. Çdo komunikim nëpërmjet telefonit, email-it, apo mjeteve të tjera, që përfaqëson një ftesë ose marketing për të investuar në platformën online me emrin Fortrade, është i jashtëligjshëm.

Publiku duhet të jetë i qartë se Autoriteti nuk monitoron ligjshmërinë e aktivitetit të shoqërisë Fortrade dhe nuk mund të mbrojë interesat e të gjithë atyre, që investojnë në subjekte apo platforma të palicencuara, siç është edhe platforma me emrin Fortrade.

Autoriteti është në komunikim të vazhdueshëm me institucionet e tjera ligjzbatuese për të ndaluar aktivitetin e shoqërive të palicencuara.

Lista e shoqërive të licencuara nga AMF për ofrimin e shërbimeve për investime gjendet në faqen zyrtare të AMF-së në Rubrikën Regjistri i të Licencuarëve/Tregu i Titujve.

Nëse subjekte të palicencuara nga AMF ju kontaktojnë për t'ju ofruar produkte dhe/ose shërbime financiare, ju lutem të na kontaktoni në amf@amf.gov.al apo në numrin e telefonit + 355 (0) 4 2257560.

—○○○—
Autoriteti i Mbikëqyrjes
Financiare (AMF)
paralajmëron investitorët
për rrezikun ndaj
shërbimeve të shoqërisë
që operon me emrin
Fortrade nëpërmjet
adresës së internetit
<https://www.fortrade.com>

AMF me studentët e “Tirana Business University” për rritjen e edukimit financiar



Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i AMF-së, Z. Ervin Koçi dhe Rektori, Prof. Dr. Lavdosh Zaho gjatë nënshkrimit të marrëveshjes

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare zhvilloi më datë 7 dhjetor një takim informues me studentë të Kolegjit Universitar “Tirana Business University”.

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare zhvilloi më datë 7 dhjetor një takim informues me studentë të Kolegjit Universitar “Tirana Business University”. Aktiviteti u zhvillua në vazhden e fushatës informuese të nisur nga AMF për rritjen e edukimit financiar të studentëve, pjesë e “Strategjisë për rritjen e besimit të konsumatorit/investitorit në tregjet financiare nën mbikëqyrje”.

Aktivitetit i parapriu nënshkrimi i një marrëveshjeje bashkëpunimi mes AMF dhe Kolegjit Universitar “Tirana Business University” nga Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, Z. Ervin Koçi dhe Rektori, Prof. Dr. Lavdosh Zaho.

Në fjalën e mbajtur në takim, Z. Koçi u shpreh se AMF e cilëson si një nga prioritetet kryesore rritjen e edukimit financiar, me fokus të rinjtë. Në njëërën anë, kjo shërben për përgatitjen më të mirë të studentëve dhe rritjen e mundësive të punësimit në tregjet nën mbikëqyrjen e Autoritetit. Në anën tjetër, i bën të rinjtë konsumatorë apo investitorë më të ndërgjegjshëm dhe më të mbrojtur në të ardhmen. Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv theksoi se marrëveshja u mundëson studentëve ndjekjen e praktikave mësimore, apo intershipeve pranë Autoritetit.

Rektori i Kolegjit Universitar “Tirana Business University”, Z. Zaho u deklarua besimplotë se marrëveshja e nënshkruar mes dy institucioneve do të jetë me përfitim reciprok. Sipas tij ajo do të jetë një bazë e mirë për thellimin e bashkëpunimit mes dy institucioneve për rritjen e edukimit financiar dhe përgatitjen e studentëve për tregun e punës.

Në orën e hapur të leksionit, studentët u njohën me rolin dhe funksionet e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, si një institucion i pavarur.

Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i AMF-së takohet me përfaqësues të lartë të MONEYVAL



Gjatë takimit të Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv të AMF-së, Z. Ervin Koçi me përfaqësuesit e lartë të MONEYVAL

Në takim u diskutua mbi rezultatet e raportit të vlerësimit të masave kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit dhe progresi i bërë nga AMF në zbatim të rekomandimeve të lëna nga grupi i ekspertëve.

Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, Z. Ervin Koçi zhvilloi më 17 dhjetor 2018 një takim me kryetarin e Komitetit të Ekspertëve për Vlerësimin e Masave kundër Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit pranë Këshillit të Evropës (MONEYVAL), Z. Daniel Thelesklaf.

Në takim u diskutua mbi rezultatet e raportit të vlerësimit të masave kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit dhe progresi i bërë nga AMF në zbatim të rekomandimeve të lëna nga grupi i ekspertëve. Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv, Z. Ervin Koçi bëri një pasqyrë të planit të punës së Autoritetit për plotësimin tërësor të rekomandimeve.

Përfaqësuesit e lartë të MONEYVAL vlerësuan progresin e bërë, që jep sinjale pozitive për sektorin financiar, megjithëse tregu financiar jobankar nën mbikëqyrjen e Autoritetit është treg i vogël. AMF në koordinim dhe bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave (DPPPP), Bankën e Shqipërisë dhe agjencitë e tjera ligjzbatuese vijon me zbatimin e rekomandimeve të lëna. Përfaqësuesit e MONEYVAL vlerësuan si një faktor mjaft të rëndësishëm bashkëpunimin midis këtyre institucioneve në Shqipëri.

AMF bashkëpunon me projektin e Swisscontact “Aftësi për Punë” për edukimin financiar në shkollat e mesme profesionale

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare ka nënshkruar më 11 dhjetor 2018, një marrëveshje bashkëpunimi me projektin e Swisscontact “Aftësi për Punë, S4J”. Në vazhdim të zbatimit të “Strategjisë për rritjen e besimit të konsumatorit/investitorit në tregjet financiare nën mbikëqyrje”, AMF zgjeron grupet e interesit në fushatën e nisur për rritjen e edukimit financiar.



Në ambientet e Swisscontact për nënshkrimin e marrëveshjes

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare ka nënshkruar më 11 dhjetor 2018, një marrëveshje bashkëpunimi me projektin e Swisscontact “Aftësi për Punë, S4J”.

Marrëveshja u nënshkrua nga Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i AMF-së, Z. Ervin Koçi dhe nga Z. Fation Dragoshi, Menaxher i projektit “Aftësi për Punë, S4J”, me praninë e Z. Henry Leerentveld, Drejtor Rajonal i Swisscontact për Evropën Lindore. Në bazë të marrëveshjes, Autoriteti do të zhvillojë takime informuese me nxënës të shkollave të mesme profesionale, pjesë e projektit, me profil ekonomi-biznes, në disa qytete të vendit.

Nga ana tjetër, nxënësit e shkollave mund të kryejnë praktika mësimore në kuadër të profilin e tyre të studimit pranë AMF-së, ashtu si edhe intershipe të ndryshme, ku do të asistohen nga punonjës të Autoritetit. Nga ky bashkëpunim përfitojnë direkt 5 shkolla profesionale, Shkolla Teknike Ekonomike në Tiranë, Shkolla Tregtare në Vlorë, Shkolla “Hamdi Bushati” në Shkodër, “Kolin Gjoka” në Lezhë dhe “Kristo Isak” në Berat.

Takim i nivelit të lartë ndaj sfidave në tregjet e sigurimeve të rajonit të Evropës Juglindore

Në datat 3-4 dhjetor, u zhvillua në Vjenë, konferenca me temë “Sfidat në tregjet e sigurimeve në rajonin Evropës Juglindore”. Në këtë takim, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare u përfaqësua nga Z. Ervin Koçi, Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv dhe përfaqësues të nivelit të lartë.

Konferenca u fokusua në tre tema kryesore:

- Zhvillimet e fundit në tregjet e sigurimeve dhe mbikëqyrja e tyre;
- Përshtypja e tre viteve të Solvency II në vendet e BE-së dhe sfidat në rrugën drejt Solvency II për vendet jo anëtare të BE-së;
- Sfidat dhe arritjet në strukturat e Autoriteteve Mbikëqyrëse.

Pjesëmarrësit prezantuan zhvillimet kryesore të tregut të sigurimeve të vendeve përkatëse, duke u fokusuar kryesisht në treguesit si Mjaftueshmëria e Kapitalit dhe Aftësia Paguese, aktivet që mbulojnë rezervat teknike dhe matematikore, raporti deme/prime neto, niveli i primeve, niveli i dëmeve të pagaura, penetrimi i sigurimeve, si dhe zhvillimet më të fundit në kuadrin ligjor të sigurimeve, etj.

Në pjesën e dytë pjesëmarrësit prezantuan, si dhe diskutuan raste konkrete lidhur me problematikat e hasura në tregun e sigurimeve duke paraqitur se cilat janë sfidat aktuale në këtë treg dhe objektivat e ardhshëm për zgjidhjen e tyre. Gjithashtu, nisur nga problematika të ngjashme në rajon u shkëmbyen eksperiencia lidhur me trajtimin dhe zgjidhjen e tyre në vende të ndryshme.

Në pjesën e tretë të konferencës pjesëmarrësit nga vendet anëtare të BE-së sollën eksperiencën e tyre lidhur me zbatimin e kërkesave të Solvency II, zbatimin e saj dhe ndikimet në tregun e sigurimeve.

Në datat 3-4 dhjetor, u zhvillua në Vjenë, konferenca me temë “Sfidat në tregjet e sigurimeve në rajonin Evropës Juglindore”. Në këtë takim, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare u përfaqësua nga Z. Ervin Koçi, Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv dhe përfaqësues të nivelit të lartë.

Konferencë vjetore për mbikëqyrjen financiare

Në datat 6-7 dhjetor, në Bruksel u zhvillua Konferenca Vjetore për Mbikëqyrjen Financiare në BE. Pjesëmarrës në këtë konferencë ishin rregullatorë të ndryshëm nga rajoni, si dhe nga bankat qendrore, autoritetet mbikëqyrëse të BE-së, si dhe juristë nga tregu privat bankar.

Temat kryesore që u trajtuan në këtë konferencë ishin:

- Brexit dhe ndikimi në sektorin financiar;
- Kriptomonedhat dhe qasja ndaj tyre;
- Rregullimi që i bën Malta aseteve virtuale;
- Plani i Veprimit të Komisionit Evropian për Fintech;
- Basel IV dhe rëndësia e kapitalit për Bankat;
- Propozimi i Komisionit Evropian për ndryshimin e rregullave të veprimtarisë së ESMA-s;
- Ndikimi i teknologjive të reja në sektorin financiar.

Gjatë zhvillimit të kësaj konference pjesëmarrësit diskutuan për përvojat e vendeve të ndryshme lidhur me çështjet e trajtuara. Të gjitha temat dhe eksperiencat e sjella ishin një ndihmesë për punën e përditshme të rregullatorëve, për adresimin e sfidave të reja me të cilat përballet zhvillimi i sektorit financiar.

Takimi i tretë i 6 vendeve të Ballkanit Perëndimor – Grup Pune për Tregjet e Kapitalit

Takimi i tretë i Grupit Punues për Tregun e Kapitalit / Tregjet Financiare pjesë e bashkëpunimit rajonal të gjashtë vendeve të Ballkanit Perëndimor i emërtuar WB6 u organizua nga Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal (RCC), në Podgoricë më 11 dhjetor 2018.

Ky takim diskutoi mbi mundësitë e avancimit të kësaj pune drejt zhvillimit të përgjithshëm të tregjeve financiare dhe fillimin e diskutimit të rezultateve të mundshme për Samitin e ardhshëm të Kryeministrave të WB6 (në korrik 2019 në Poloni).

Viti 2017 dhe 2018 ishin piketa të rëndësishme për zhvillimin e tregjeve të kapitalit të Ballkanit Perëndimor, brenda kontekstit të Planit Shumëvjeçar të Veprimit për Zonën Ekonomike Rajonale (MAP REA).

Në datat 6-7 dhjetor, në Bruksel u zhvillua Konferenca Vjetore për Mbikëqyrjen Financiare në BE.

Grupi rajonal i punës për tregjet e kapitaleve i themeluar më parë përgatiti një propozim për një program rajonal për zhvillimin e tregjeve të kapitalit, i cili iu është përcjellë për shqyrtim kryeministrave të rajonit në kuadër të "Procesit të Berlinit" dhe Samitit të WB6 që u zhvillua në Londër, korrik 2018. Duke pasur parasysh punën e bërë më parë në tregjet e kapitalit, takimi do të synojë gjithashtu të vazhdojë me këtë punë pa humbur ritmin e avancimit duke synuar përparimin në kapitullin e tregjeve të kapitalit dhe strategjisë së përgjithshme të tregjeve financiare.



Gjatë zhvillimit të takimit

Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal (RCC) do të vazhdojë të koordinojë këtë qasje drejt përfitimeve më të mëdha për diversifikimin e sektorit financiar duke i shërbyer rritjes ekonomike, rritjes së vendeve të punës dhe duke përfshirë edhe lojtarë të tjerë në këtë fushë përveç tregjeve të kapitalit, si fondet e sigurimeve, fondet e investimeve, fondet e pensioneve, kapitalit të ndërmarrjeve dhe të tjerëve.

Puna do të përfshijë gjetjen e sfidave kryesore për zhvillimin e sektorit financiar, përgatitjen e masave adekuate për adresimin e këtyre sfidave dhe zbatimin e masave të dakorduara nëpërmjet mekanizmit koordinues të RCC (Grupi Punues për Tregjet Financiare) duke përfshirë autoritetet përkatëse të rajonit dhe palët e interesuara dhe partnerët e tjerë Banka dhe të tjerët). Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare është anëtar i këtij grupi pune për tregjet e kapitalit.

Grupa rajonal e punës për tregjet e kapitaleve i themeluar më parë përgatiti një propozim për një program rajonal për zhvillimin e tregjeve të kapitalit.

Tejkalimi i limiteve në sigurueshmëri

Z. François Villeroy de Galhau, Kryetar i Autoritetit të Mbikëqyrjes së Kujdesshme dhe Rezolutave, si edhe Guvernator i Bankës së Francës në fjalën e tij përshëndetëse në Konferencën 10-të Ndërkombëtare për sigurimet adreson tri çështje të rëndësishme:

(i) Siguruesit luajnë një rol esencial në financimin e ekonomisë;

(ii) Ndërhyrje në kuadrin rregullator;

(iii) Adresimi i emergjencave në lidhje me rreziqet të reja

Konferenca ndërkombëtare u organizua në Paris në 26 tetor 2018.

(Pjesa e parë, me shkurtime dhe redaktime)

Ne nuk e theksojmë aq shpesh sa duhet, por sektori financiar është një nga pikat e forta kyçe të ekonomisë franceze. Një çështje tjetër që ja vlen të theksohet është se brenda këtij sektori financiar, siguruesit luajnë një rol të rëndësishëm në financimin e ekonomisë sonë. Kjo do të jetë çështja e parë ku do të fokusohem dhe më pas do të vazhdoj me zhvillimet rregulatore, duke përgëzuar progresin e bërë gjatë vitit të kaluar dhe duke zgjedhur disa sfida evropiane të cilat duhet t'i përballojmë së bashku. Në mbyllje do të flas për "limitet e aftësisë siguruese".

Tema e sotme është e vjetër po aq sa profesioni juaj, që daton nga marrëveshjet e hershme të përdorura për të mbrojtur sipërmarrjet në sektorin e transportit detar në kohët e lashta dhe policën e parë të sigurimit të shkruar në Genova më 1347. Por kjo çështje ka zënë vend me një urgjencë të re në kohët e sotme, me emergjencën përballë rreziqeve të reja, veçanërisht ato që kanë të bëjnë me ndryshimet klimatike.

I. Siguruesit luajnë një rol esencial në financimin e ekonomisë

Në raportin vjetor statistikor të publikuar së fundmi nga Autoriteti i Mbikëqyrjes së Kujdesshme dhe Rezolutave (*Autorité de Contrôle Prudentiel et de Resolution, ACPR*) tregohet se sektori francez i sigurimeve është në një formë të mirë. Raporti i Mbulimit të Kapitalit të Kërkuar, si mesatare (*average solvency capital requirement (SCR) coverage ratio*) në tregun francez shënoi një rritje nga 222% në vitin 2016, në 238% në vitin 2017.

Për më tepër, në tremujorin e parë të vitit 2018, tregu francez i sigurimeve tejkaloi Gjermaninë dhe Mbretërinë e Bashkuar duke zënë vendin e parë në tregun evropian, me mbi 35 miliardë euro në primet e shkruara në sigurimin e Jo-Jetës dhe mbi 2,100 trilion euro në provigjone teknike. Tregu francez i sigurimeve është gjithashtu lider edhe në kapacitetet investues.

Në tremujorin e parë të vitit 2018, tregu francez i sigurimeve tejkaloi Gjermaninë dhe Mbretërinë e Bashkuar duke zënë vendin e parë në tregun evropian, me mbi 35 miliardë euro në primet e shkruara në sigurimin e Jo-Jetës dhe mbi 2,100 trilion euro në provigjone teknike.

Aplikimi në Francë i një takse të sheshtë mbi të ardhurat e kapitalit që prej datës 1 janar nuk ka pasur as më të voglin efekt negativ në sigurimin e Jetës, pavarësisht frikës që vetë industria kishte nga ndikimi i kësaj takse.

Në shtator 2018, totali i aktiveve arriti në 2.7 trilion euro, duke e bërë sektorin e sigurimeve të Francës investitorin më i madh institucional në Evropë, duke pasur më shumë se një të tretën e totalit të aktiveve të siguruesve të eurozonës. Për të dhënë një krahasim, Franca mbulon 21% të PBB-së në eurozonë.

Pra, siguruesit, janë një aset i rëndësishëm për Francën dhe roli i tyre themelor në financimin e ekonomisë mund dhe duhet të rritet më tej. Kapitali aksionar i korporatave është jetik për inovacionin dhe si rrjedhojë, në një ekonomi të gjallë. Por në mesin e vitit 2018 ky kapital ishte ekuivalent me vetëm 77% të PBB-së në eurozonë dhe 76% në Francë, krahasuar me 124% në Shtetet e Bashkuara.

II. Ndërhyrje në kuadrin rregullator

Aplikimi në Francë i një takse të sheshtë mbi të ardhurat e kapitalit që prej datës 1 janar nuk ka pasur as më të voglin efekt negativ në sigurimin e Jetës, pavarësisht frikës që vetë industria kishte nga ndikimi i kësaj takse. Gjithashtu, Ligji i Ri mbi Planin e Veprimit për Zhvillimin dhe Transformimin e Kompanive (*Plan d'Action pour la Croissance et la Transformation des Entreprises*, PACTE), i cili u miratua në leximin e parë nga Asambleja Kombëtare, synon të promovojë investimet e kapitalit si dhe investimet afatgjata.

Diskutimet tona në fillim të procesit ndihmuan në krijimin e këtij legjislacioni, dhe bënë që ligji të parashikonte masa për të reformuar produktet e sigurimit të Jetës për rritjen ekonomike të vendeve të eurozonës “eurogrowth” (*Eurocroissance*), duke vendosur një target ambicioz, për të cilin ju të gjithë jeni në dijeni, rreth 20 miliardë euro krahasuar me 2 miliardë euro në kushtet aktuale. Në përputhje me këtë, ligjvënësit e Francës kanë rritur mjetet e aplikuara për të arritur këtë qëllim.

Tani ka ardhur koha për të nxjerrë në treg produktin. Ne kemi të drejtë të presim një fillim të ri, duke nisur me produktet eurogrowth dhe përpjekje të reja, energjike të marketingut nga industria e sigurimeve paralelisht me thjeshtëzimin e kuadrit ligjor. Ndërkohë për kursimet nga pensionet, ka vazhduar debati për format e kursimit si një pagesë mbi të ardhurave vjetore apo shumë totale.

Sikurse edhe ju, unë jam i kënaqur që aftësia për të marrë pagesa të pensionit mbi baza vjetore dhe mbi të gjitha parimi i një produkti të të ardhurave vjetore, është ruajtur, jo për të mbrojtur njëri industri ndaj tjetrës, por për shkak se të ardhurat e Jetës janë afër produktit të daljes në pension, edhe sepse kjo kornizë duhet të mbështesë më shumë investime kapitali.

Megjithatë, ju mbetet juve të ndërmerrni hapat për të mundësuar që kursimet e pensionit të fillojnë më së fundi edhe në Francë dhe për të siguruar që qasja juaj ndaj menaxhimit të aktiveve/detyrimeve të marrë më tepër në konsideratë kohëzgjatjen më të madhe të këtyre produkteve. Nevojat janë të mëdha, dhe qëllimi i rritjes së aktiveve të mbajtura nga produktet e kursimeve të pensionit nga 200 miliardë në 300 miliardë euro është brenda mundësive tonë.

Do të theksoja gjithashtu nevojën për të siguruar që mbajtësit e policave të informohen si duhet rreth produkteve të kursimeve të pensionit, por edhe mbi të gjitha produktet e lidhura me skemat e sigurimit të jetës (*unit linked products*) nëse ato nuk përfshijnë garanci kapitali.

AKTUAR

Është personi i licencuar nga Autoriteti, sipas përcaktimeve të këtij ligji, i cili, ndër të tjera, ka si detyrë kryesore llogaritjen e tarifave të primeve, tabelave të probabilitetit, provigjoneve dhe dividendëve, duke u mbështetur në teori shkencore që lidhen me investimet, statistikën, matematikën, financën dhe demografinë.

DËMSHPËRBLIM I SIGURIMIT

Është çdo shumë, për të cilën siguruesi i detyrohet të siguroarit, përfituesit ose ndonjë pale tjetër të dëmtuar, e cila rrjedh si e drejtë nga një kontratë sigurimi apo veprimtari sigurimi, sipas klasave të parashikuara në aneksin I, të këtij ligji, përfshirë këtu edhe shumat e vëna mënjanë për personat e lartpërmendur, kur disa elemente të detyrimit nuk janë ende të njohura.

I SIGURUAR

Personi, humbja e mundshme pasurore dhe/ose jopasurore e të cilit është objekt i një kontrate sigurimi. Në kontratat e sigurimit të jetës i siguruari është personi, për jetën e të cilit është lëshuar një kontratë sigurimi.

PERIUDHË E MBULIMIT NGA SIGURIMI

Periodha për të cilën një sigurues mbulon ndodhjen e rrezikut të sigurimit.

PRODUKT SIGURIMI

Kontrata (polica) specifike e përgatitur dhe e lëshuar nga shoqëria e sigurimit për të mbuluar një rrezik specifik ose një numër rreziqesh të veçanta, sipas kushteve të parapërcaktuara.

SIGURIM

Transferimi i një rreziku të mundshëm, i një humbjeje pasurore dhe/ose jopasurore nga i siguruari te siguruesi, sipas një kontrate sigurimi.

SIGURUES

Shoqëria e sigurimit, e cila merr përsipër sigurimin e një rreziku sipas kontratës së sigurimit.

RISIGURIM

Pranimi i rreziqeve të marra përsipër nga një shoqëri sigurimi/risigurimi në një shoqëri tjetër risigurimi.

Bullgari

www.xprimm.com

Komisioni i Mbikëqyrjes Financiare (FSC) në Bullgari po bashkëpunon me aktorët e tregut dhe kompanitë e FinTech për përfshirjen e inovacioneve teknologjike financiare në tregjet nën mbikëqyrje. Në faqen zyrtare të FSC-së, në seksionin e Inovacionit Financiar është krijuar një aplikacion, i quajtur Këndi i Inovacionit, që shërben për këshillim ligjor dhe si një guidë informacioni për tregjet nën mbikëqyrje. Këndi i Inovacionit shërben edhe si një pikë takimi mes mbikëqyrësit dhe shoqërisë, gjë që e lehtëson bashkëpunimin. Gjithçka bëhet në funksion të rritjes së transparencës dhe përdorimit të teknologjisë në favor të konsumatorit.

Maqedoni

www.xprimm.com

Autoritetet rregullatore financiare në Maqedoni kanë nisur zbatimin e një projekti 5-vjeçar për edukimin financiar, me mbështetjen e Ministrisë së Financës të Holandës dhe Rrjetit të Edukimit Financiar të OECD-së. Për këtë qëllim është ngritur një ekip koordinimi nga institucionet rregullatore financiare: Agjencia e Mbikëqyrjes së Sigurimeve, Banka Kombëtare e Republikës së Maqedonisë, Ministria e Financave, Komisioni i Titujve dhe Letrave më Vlerë dhe Agjencia për Mbikëqyrjen e Pensioneve Private. Në këtë projekt janë të përfshirë edhe shtete që kanë shfaqur interes për rritjen e edukimit financiar, ose që kanë ndërmarrë nisma konkrete në këtë drejtim si Rumania, Kroacia, Mali i Zi, Bullgaria, Moldavia dhe Gjeorgjia.

Poloni

www.xprimm.com

Siguruesit në Poloni raportuan një volum primesh të shkruara bruto prej 10.84 miliardë euro për 9-mujorin e vitit 2018, me një rritje prej 1.2% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Shoqëritë paguan 6.87 miliardë euro dëme në këtë periudhë, shumica të lidhura me sigurimin motorik. Sigurimi i Jetës vijoi trendin rënës gjatë këtij viti, duke shënuar ulje me 9.5% dhe duke arritur në 3.84 miliardë euro. Sigurimi i Jo-Jetës u rrit me 8.27%, duke arritur në 6.99 miliardë euro.

Qipro

www.xprimm.com

Siguruesit në Qipro raportuan një volum primesh të shkruara bruto prej 651 milionë euro për 9-mujorin e vitit 2018, me një rritje prej 7.2% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Sigurimi i Jetës u rrit me 10%, duke arritur në 288 milionë euro, ndërsa sigurimi i Jo-Jetës u rrit me 5.2%, duke arritur në 363 milionë euro. Përsa i përket dëmeve, në sigurimin e Jetës u paguan 151 milionë euro, 4.6% më pak se e njëjta periudhë e vitit të kaluar. Në sigurimin e Jo-Jetës u paguan 133 milionë euro.

Rumani

www.xprimm.com

Tregu i sigurimeve në Rumani e mbylli 9-mujorin e vitit 2018 me një volum primesh të shkruara bruto prej 1.6 miliardë euro, me rritje 0.7%. Dëmet e paguara nga shoqëritë për këtë periudhë janë 918 milionë euro, me një rritje prej 13.1%. Sigurimi i Jetës u rrit me 2.5%, duke arritur në 340.7 milionë euro prime të shkruara bruto. Tregu i sigurimit të Jo-Jetës realizoi një volum të primeve të shkruara bruto prej 1.25 miliardë euro. Rënie pati sigurimi MTPL me 6.85%, ndërsa produktet e sigurimit të Jo-Jetës patën rritje.

Nëntë shoqëri sigurimi të Jo-Jetës dhe Shoqata e Siguruesve në Rumani janë gjositur nga Këshilli i Konkurrencës me 53 milionë euro për shkelje të rregullave kombëtare dhe europiane të konkurrencës, pasi në bashkëpunim mes tyre kanë rritur çmimet e primeve për siguracionet MTPL. Pjesa më e madhe e shoqërive të ndëshkuara kanë deklaruar se do ta ankimojnë vendimin në gjykatë. Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare në Rumani i ka marrë në konsideratë gjobat e vendosura dhe ka dhënë garanci se do të vijojë të bashkëpunojë për të përmirësuar kuadrin ligjor dhe rregullator në mbrojtje të konsumatorit.

Humbjet nga katastrofat natyrore

www.xprimm.com

Humbjet e përgjithshme ekonomike në nivel botëror nga katastrofat natyrore dhe fenomenet e shkaktuar nga dora e njeriut vlerësohet të jenë rreth 155 miliardë dollarë për vitin 2018. Nga kjo shifër, 79 miliardë dollarë rezultojnë të mbuluara nga sigurimi. Më shumë se 50% e humbjeve ekonomike janë dëmshpërblyer nga shoqëritë e sigurimit, që kanë dhënë një kontribut të rëndësishëm për të lehtësuar njerëzit dhe bizneset e prekura. Parashikohet që ky vit të jetë viti i katërt më i shtrenjtë për siguruesit përsa i përket dëmeve të paguara për këtë lloj sigurimi.



AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

Për informacion të mëtejshëm
ju lutemi na kontaktoni:

Rr. "Dora D'Istria", Nr. 10 , P.O.Box 8363, Tiranë
Tel: +355 42 251 355/6 | Fax: +355 42 250 686
amf@amf.gov.al | www.amf.gov.al